



UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"

SENATI AKADEMIK

Nr 473 Prot.Gjirokastrër, më 18 / 03 /2019

V E N D I M

Nr 09, datë 18.03.2019

PËR PROF. DR ARBEN MALAJ

Në zbatim VKM nr. 112, datë 23.02.2019 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademik "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor" kreu V pika 1, Senati Akademi në mbledhjen e tij të datës 18.03.2019 diskutoi për akordimin e titullit akademik "Doktor Honoris Causa" prof.dr. Arben Malaj, pas propozimit dhe motivacionit të ardhur nga FE si dhe pas pëlqimit të dhënë nga MASR me shkresën nr. 10184/1, datë 10.01.2019 dhe

VENDOSI

1. T'i akordojë titullin "Doktor Honoris Causa" prof.dr. Arben Malaj me motivacionin:

Personalitet me veprimtari të shquar akademike-universitare dhe kërkimore-botuese; protagonist i suksesshëm prej dekadash në fushën e ekonomisë e të financave; ligjvënës e shtetar me stimë popullore të gjerë; kërkues vizionar dhe kontribues i suksesshëm në mësimdhënien e disiplinave ekonomike në universitete shqiptare e të huaja; ligjërues virtuoz i disiplinave të politikës makroekonomike, fiskale dhe të investimeve publike; me kontribute të rëndësishme parësore në përngritjen e cilësisë akademike e të kërkimit shkencor në Universitetin *Eqrem Çabej* të Gjirokastrës, veçanërisht të Fakultetit Ekonomik, mbështetës i nismave dhe projekteve të tij.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof.dr.Bektash MEMA

